REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 492/25 Dt. 12.08.2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 4 dhe 7 të Rregullores (QRK) nr. 10/2023 për Kompensimin për Funksionet Shtesë, pika 8 e Qarkores së Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. ref. 356/2023 të datës 21.03.2023 rreth zbatimit të Rregullores (QRK) nr. 10/2023 për Kompensimin për Funksionet Shtesë, dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për ekzekutimin e pagesës për kompensimin e punës së Komitetit të Auditimit të Brendshëm të Komunës së Prizrenit

1. Miratohet vendimi për ekzekutimin e pagesës për kompensimin e punës të Komitetit të Auditimit të Brendshëm të Komunës së Prizrenit.

2. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, që konformë vendimit të Kryetarit të Komunës për themelimin e Komiteti i Auditimit të Brendshëm për Komunën e Prizrenit 01 nr. 326, datë 27.05.2025, të bëj kompensimin e anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm, prej 30% të pagës bazë të Zyrtarit Kryesor Administrative për kryesuesin e Komitetit dhe 20 % për anëtarët e Komitetit sipas listës së nënshkrimeve dhe procesverbale të takimeve të mbajtura të Komitetit të Audititmit të Brendshëm.

3. Shuma e lejuar, e përshkruar në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i pagave dhe mëditjeve dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

4. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Komiteti i Auditimit të Brendshëm dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore,
- Komitetit të Auditimit të Brendshëm,
- Njësisë së Auditimit të Brendshëm,
- Anëtarëve të Komitetit,
- Arkivës së Kryetarit.